

CAGLIERO 11

Buletini i Animimit Misionar Salezian

Botim i Dikasterit për Misionet për Bashkësitë Saleziane dhe miqtë e misioneve Saleziane



Fort të dashur Salezianë dhe miq të misionit salezian,

Fort të dashur bashkëvëllezër dhe miq të misioneve saleziane! Ashtu si në 4 vitet e fundit, edhe këtë muaj mbërriti numri i 50-të i “Cagliero 11”.

Një falënderim i madh i shkon shumë miqve, të gjithë atyre që kanë ndihmuar dhe ndihmojnë në mënyrë të veçantë në përgatitjen e tij: misionarët që bashkëndajnë, botuesin që është i qetë dhe i qëndrueshëm, mjeshtrin e *lay out* që është shumë i saktë dhe mbi të gjitha përkthyesve që përkthejnë në gjuhët e mëposhtme: italisht, spanjisht, frëngjisht, portugalisht, polonisht, në gjuhën kineze, koreane, kroatisht, japonisht, vietnamisht, holandisht, çekisht, sllovakisht dhe Shqip.

Pas katër vitesh jete të Cagliero 11 mund të dallojmë shumë fryte.

Falë thjeshtësisë së tij, rregullsisë dhe eksperiencës së gjallë misionare, është mirëpritur nga Salezianët dhe nga anëtarët e Familjes Saleziane në plot 14 gjuhë. Po bëhet një pjesë e jetës së përditshme në bashkësitë saleziane: i vendosur mbi frigorifer në dhomën e ngrënies së Bashkësisë, i përdorur për animimin e Lutjeve të Mëngjesit në shumë Bashkësi dhe shtëpi formimi; disa eksperiencë janë marrë nga Buletini Salezian nga Revista e Inspektorisë ose thjesht dërgohet muaj për muaj nga Delegati i Inspektorisë për Animimet Misionare

ose nga Sekretari i Inspektorisë të gjitha Bashkësitë. Për disa salezianë është hapi i parë në zbulimin e thirrjes misionare.

Rrethi virtuoz i Rinisë misionare është ende i gjallë. Shumë të rinj misionarë bashkëndajnë me zemër të hapur eksperiencën e tyre të jetës. Njohja e bukurisë së jetës misionare zgjon ndërgjegjen misionare të disa të rinjve dhe salezianëve. Tregimi i një eksperience në vetvete krijon një histori tjetër të gjallë misionare.

Sfida kryesore e “Cagliero 11” është ende e vlefshme. Nuk kemi mbërritur ende të gjitha Bashkësitë vendore, ashtu siç ëndërronim katër vite më përpara në numrin e parë: “Me

Cagliero 11 duam të arrijmë tek të gjitha bashkësitë saleziane të botës, për t’u kujtuar të paktën një herë në muaj që të lutemi për të gjithë misionarët *ad gentes*; njëkohësisht t’i kujtojmë, e t’ia kujtojmë vetes se të gjithë ne jemi të thirrur për të qenë “misionarë të të rinjve” (Janar 2009).

Si mund të na ndihmosh sot? Para së gjithash duke e shpërndarë Cagliero11: duke na dërguar një adresë të re ose një eksperiencë personale misionare, duke botuar Cagliero11 në Bashkësinë tënde ose duke krijuar një link në faqen tonë web ose në Facebook.

Por ndihma më e mirë është që ta përdorësh në lutjen që bëni me bashkësinë tuaj!

D. Vaclav Klement, SDB

Këshilltar për Misionet



25 shkurt 2013

Të kujtojmë në mënyrë të veçantë në lutjet tona të gjithë salezianët misionarë me rastin e festës së Shën Luigj Versiglia dhe Callisto Caravario, martirë Salezianë.



Video

vimeo: <https://vimeo.com/57513662>
<http://www.missionidonbosco.tv/video/1353/gms-2013-interview-to-father-g>



Edhe pse mund të bëjmë pak... Shpirti vepron

Thirrja ime misionare ka lindur shumë vite më përpara. Kur isha 13 vjeç mendoja për thirrjen time. Ndërkohë shumë gjëra kishin ndryshuar dhe i kisha rimenduar, por ëndrra kishte mbetur, mbaj mend të kem folur me Inspektorin tim në vigjilje të kushteve të mia të para, i shpreha dëshirën time misionare. Rreth 15 vjet më vonë bisedova sërish me Inspektorin. Ai më kërkoi të prisja, dhe të shërbeja - ndërkohë - si drejtor në bashkësi dhe si famullitar. Dy vite më përpara, më ftuan në Azerbajxhan.

Kursi për Misionarët e Rinj në Romë dhe në Torino më ndihmoi të përfundojë eksperiencat e mia të mëparshme, të lutesha, të mësoja gjëra që më duheshin para se të nisesh për në mision, të thithja ajrin e pëshpirtërisë saleziane misionare, të takoja misionarë, dhe mbi të gjitha, të flisja me Këshilltarin e misioneve. Pata mundësi të njihja edhe misionarë të rinj dhe së bashku bëme pelegrinazhin mbi vendet që kishin lidhje me misionarin e madh Shën Palin në Romë dhe në vendet saleziane. E quaj ftesën për të shkruar rregullisht në ditarin shpirtëror si një dhuratë e çmueshme e Kursit.

Këtu në Azerbajxhan kam hasur sfida të ndryshme: një kulturë të re, një situatë të re fetare, gjuhë të reja. Prania e Kishës Katolike është shumë e kufizuar. Pas ekzekutimit të meshtarit të fundit katolik në vitet tridhjetë nën regjimin komunist, deri në vitin 1997 i gjithë Vendi ishte pa asnjë kishë dhe pa asnjë meshtar katolik. Prania e Kishës Katolike është toleruar për shërbimin e të huajve dhe banorëve të vendit me prejardhje të huaj.

Popullsia e konsideron veten si muslimanë dhe apostullati nuk lejohet. Vetëm kush vjen në kishë mund të dëgjojë ndonjë gjë mbi krishterimin. Gjuhët liturgjike janë rusishtja dhe anglishtja. Gjuha e vendit është krejtësisht e ndryshme. E njëjta gjë vlen edhe për kulturën, e lidhur ngushtë me fenë myslimane. Pothuajse të gjithë besojnë në Hyjin, por mbi fenë e tyre nuk dinë pothuajse asgjë. Nga viti 2000 jeton një bashkësi saleziane në kryeqytetin Baku, qytet me përrreth 3 milion banorë. Në kishë vijnë rregullisht rreth 200 të huaj dhe 100 katolik, banorë të vendit. Shpesh vjen ndokush që interesohet mbi krishterimin ose kërkon ndihmë. Të rinjtë katolikë janë të paktë.



Ashtu siç na e kujtuan gjatë *Kursit për Misionar të Rinj*, do të duhen vite gjersa unë të përfshihem mirë në këtë kulturë. Por gjëja më e rëndësishme është t'ia kujtojmë vetes se është Shpirti Shenjt që vepron tek zemrat. Dhe ky fakt më mbush çdo ditë me gëzim dhe shpresë, edhe pse në personalisht mund të bëjmë pak. Do të doja t'iu kujtoja të rinjve salezianë që po mendojnë për jetën misionare se thirrja misionare është një dhuratë shumë e madhe e Hyjit. Nëse pas një arsyetimi të gjatë zbulohet kjo dhuratë, të thënit "po" mund të mbushë krejt jetën, ashtu siç Jezusi ka mbushur jetën e Marisë, si të rinjtë kanë mbushur zemrën e Don Boskos.

Don Vladimir Baxa
Slovak, misionar në Azerbajxhan

KËRKOHEN MISIONARË PËR AZINË

Inspektoria - Shteti	Gjuhët e nevojshme	Karakteristika të ambientit, cilësi të kërkuara për misionarët
KINË Shërbime kineze	Anglisht, Kinezçe, Kantonisht	Për të ndihmuar Inspektorinë me bashkëvëllezër të rinj (Macau, HK, Taiwan) - Nevojë për koadiutor, nevojë për thirrje të forta saleziane.
FIS Pakistan	Anglisht, Urdu	Shumë pak SDB, ambient mysliman aspak i lehtë, edukim teknik – nevojë për thirrje të forta saleziane, koadiutor; formatorë
ITM Indonezi, Timor Leste	anglisht, indonezisht portugalisht, tetum	Nevojë për bashkëvëllezër të rritur (përtej moshës 50 vjeçare) si formatorë, udhërrëfyes shpirtërorë Rrëfyes, ekspert të shkollës teknike
INC Bangladesh	anglisht, bengali	Mision i ri (filloi në vitin 2009), dy prani, aspirantat/pararishtari, shkollë, famulli rurale në zonat rurale, pak Salezianë
INC Nepal	anglisht, nepali	Misione të reja (filloi në vitin 2000), tre prani, vepra sociale edukative, Feja hindu, nevojë për misionarë jashtë Rajonit të Azisë së Jugut Shtet i shënuar nga lufta civile, nevojë për misionarë me prejardhje jashtë Rajonit të Azisë së Jugut, veçanërisht koadiutorë
LKC Sri Lanka	anglisht, singalezee, Tamil	Vetëm 600 katolikë vendas dhe 3000 migrant, Islam i Moderuar; kërkesa për të ndërkombëtarizuar bashkësinë (bashkëvëllezër jo - Sllovakë)
SLK Prefekturë apostolike Azerbajxhan	rusisht, anglisht, azero	



Qëllime Misionare Saleziane

RAJONI I AFRIKËS - Republika Demokratike e Kongos

Për të rinjtë që përshkojnë me Salezianët në Afrikë ecjen e edukimit në fe, veçanërisht në katekezë: në mënyrë që, duke mirëpritur Ungjillin e Pajtimit, të jenë krijues të një shoqërie dhe të një Kishë të pajtuar dhe të pajtueshme.



Përpara një ndryshueshmërie kaq të madhe kulturore dhe etnike të jetuar në kontekstet ku jetojmë dhe punojmë në Afrikë, tundimi i ndarjes dhe i konflikteve nganjëherë është shumë i fortë, veçanërisht nga ana e të rinjve. Oferta e durueshme e ecjes ungjillëzuese dhe faljes u ofron atyre një rrugë të vështirë, por që njëkohësisht shndërrohet në ecje të sigurt të një zhvillimi të vërtetë. Të rinjtë afrikanë na habisin shpesh me aftësinë e tyre krijuese për të gjetur rrugë të reja dialogu dhe paqeje.